


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6916
E enjte, 8 qershor 2023
Çmimi 0.40

Qeveria e Kosovës abuzoi me besimin e ShBA-së

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NDËRKOMBËTARËT NUK HEQIN DORË NGA KËRKESAT E TYRE PËR SHTENSIONIMIN
E SITUATËS NË VERI TË KOSOVËS

FAQE 3

SHBA-ja DHE BE-ja INSISTOJNË NË KËRKESAT PËR QEVERINË KURTI



Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE) janë duke insistuar për zbatimin e tri kërkesave të tyre për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës. Kërkesës për shtensionim të situatës në veri i është bashkuar edhe shefi i NATO-s, Emisari i ShBA-së për Ballkanin, Gabriel

Escobar, ka theksuar se nuk ka ndonjë afat për qeverinë Kurti për zbatimin e këtyre kërkesave, por ka bërë me dije se të premtën do të raportojë në Shtëpinë e Bardhë për rezultatet e takimeve në Prishtinë dhe Beograd. Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka pranuar se ka sfida në raportet dypalëshe me emisarin

amerikan dhe atë evropian, por ka thënë se është i bindur që do të arrijnë t'i sqarojnë paqartësitë. Në anën tjetër, presidentja Vjosa Osmani ka thënë se Kosova mund t'i shpallë zgjedhjet e reja në komunat në veri, nëse "20 për qind e votuesve nënshkruajnë një peticion me këtë kërkesë"

MË 14 QERSHOR MBAHET MBLEDHJA E PËRBASHKËT E DY QEVERIVE

FAQE 7



HARADINAJ: I KEMI VOTAT E MJAFTUESHME PËR INICIMIN E MOCIONIT TË MOSBESIMIT NDAJ QEVERISË KURTI

FAQE 7



AKTUALE



AVOKATI I THAÇIT FITON
BETEJËN NË GJYKATËN SPECIALE
PËRBALLË ZPS-së

F. 3

FORMOHET GRUPI PUNUES
PËR THEMELIMIN E MUZEUT
PËR DOKUMENTIMIN E KRIMEVE
SERBE NË KOSOVË

F. 3

OSMANI DEKORON ISMAIL
KADARENË ME URDRIN
"HASAN PRISHTINA"

F. 7

210 MILIONË EURO PËR QIRANË E
BURGJEVE, QEVERIA VENDOS PËR
MARRËVESHJEN ME DANIMARKËN

F. 7

EKONOMI



QEVERIA MIRATON PROJEKTLIGJIN
PËR FONDIN SOVRAN

F. 8

EKSPERTËT KËRKOJNË NGA
QEVERIA TË VENDOSË TAKSË
PËR EMETUESIT E KARBONIT

F. 8

SPORT



FFK-ja REFUZON ANKESËN E
FERIZAJT, LIRIA NË SUPERLIGË

F. 12

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ukraina evakuon mijëra banorë pas shkatërrimit të digës Kahovka

KIEV, 7 QERSHOR - Ukraina është duke evakuuar mijëra njerëz të mërkurën pasi sulmi në digën Kahovka ka rezultuar me vërshime të mëdha. Dhjetëra fshatra tashmë i ka marrë uji i lumit Dnjepër dhe ka shqetësime për katastrofë humanitare.

Uashingtoni ka paralajmëruar se shumë njerëz mund të vdesin, ndërsa Rusia dhe Ukraina e kanë fajësuar njëra-tjetrën për sulmin në digë.

Diga i ndan forcat ruse dhe ato ukrainase në jug të Ukrainës. Kievi ka thënë se shkatërrimi i digës – kontrollin e së cilës e ka pasur Rusia prej nisjes së luftës - ka qenë tentim i Moskës për ta penguar ofensivën e shumëpritur ukrainase. Megjithatë, presidenti

ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë se ky rast nuk do të ketë ndikim në kundërofensivë.

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara e ka mbajtur një takim urgjent të martën, me kërkesë të Rusisë dhe Ukrainës. "Lajmet e sotme tregojnë se gjendja e njerëzve në Ukrainë vetëm sa do të përkeqësohet", ka thënë zyrtari i lartë i OKB-së për Çështje Humanitare, Martin Griffiths.

OKB-ja ka paralajmëruar se mijëra njerëz mund të preken nga incidenti.

Njerëzit në Herson janë në kërkim të territoreve me lartësi më të madhe, teksa lumi Dnjepër shtrihet në qytet.

Autoritetet ukrainase kanë thënë se 17 mijë njerëz janë evakuuar dhe një total prej 24 fshatrash

janë vërshuar. "Rreth 40.000 mijë njerëz janë në rrezik të vërshimeve", ka thënë prokurori i përgjithshëm, Andriy Koston.

Diga Kahovka, me lartësi prej 30 metrash dhe gjerësi prej 3.2 kilometrash, është ndërtuar më 1956 në lumin Dnjepër, në kuadër të hidrocentralit Kahovka.

Ky rezervuar e furnizon me ujë Gadishullin ukrainas të Krimesë, të cilin e ka aneksuar Rusia më 2014, si dhe centralin bërthamor në Zaporizhja, i cili, po ashtu, është nën kontrollin rus.

Rezervuari ka ujë në sasi prej 13 kilometrash kub – sasi e përafërt me Liqenin e Madh të Njelmët në shtetin amerikan, Utah. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt 2022.



Tymi i zjarreve pyjore të Kanadasë rrezikon shëndetin e miliona njerëzve



OTAVA, 7 QERSHOR - Autoritetet kanë lëshuar paralajmërimet për nivele të rrezikshme të ndotjes së ajrit në Amerikën Veriore, për shkak të zjarreve pyjore në Kanada. Tymi prej zjarreve i ka mbuluar qytetet e mëdha si Ontario, Kuebek, Toronto, dhe disa zona tjera. Tymi ka arritur deri në qytetin e Nju Jorkut dhe Kënektikut në Shtetet e Bashkuara, ku cilësia e ajrit është klasifikuar si "e pashëndetshme". Pjesa më e madhe e tymit vjen prej Kuebekut, ku aktualisht janë duke u djegur 160 zjarre. Autoritetet kanadeze e kanë lëshuar paralajmërimin më të ashpër të martën për Otavën, duke thënë se nivelet e ndotjes janë "shumë të rrezikshme" për shëndetin e njerëzve.

Në Nju Jork, fotografitë e nxjerra në mëngjesin së martës, kanë shfaqur një pamje të turbulluar, pasi tymi e ka mbuluar gjithë qytetin. Zyrtarët të shëndetit publik kanë bërë thirrje që të mos kryhen stërvitje në ambiente të jashtme, për të minimizuar ekspozimin ndaj tymit sa më shumë që të jetë e mundur. Aktualisht, Kanadaja është duke regjistruar sezon më të aktiv të zjarreve pyjore, sesa në të kaluarën. Shumë zyrtarë federalë kanë thënë të hënën se, kjo verë mund ta përballë Kanadanë me zjarret më të mëdha ndonjëherë, për shkak të kushteve të thata klimatike. Deri më tani mijëra njerëz janë larguar nga zonat afër zjarreve, përfshirë shumë banorë të Kuebekut.


Japonia shqyrton heqjen e ndalesës së tatuazheve tek ushtarët

TOKIO, 7 QERSHOR - Forcat mbrojtëse të Japonisë janë duke rishqyrtuar ndalesën që ekziston për tatuazhe tek ushtarët, pasi përpjekjet për rekrutim po rriten, por numri i popullsisë po tkurret. Tatuazhet janë temë tabu në këtë shtet, pasi ato lidhen me veprime kriminale.

Mirëpo, tani zyrtarët besojnë se të rinjtë japonezë kanë tatuazhe për arsye të ndryshme dhe jodomosdo lidhen me krime. Autoritetet, madje besojnë se ndalesa në tatuazhe është duke e ngadalësuar procesin e rekrutimit. Forcat Japoneze të Vetëmbrojtjes - ushtria e këtij shteti - ka 10 për qind më pak staf, në krahasim me kapacitetin. "Refuzimi i

aplikantëve, vetëm pse kanë tatuazhe, përbën problem sa i përket bazës së burimeve njerëzore", ka thënë Masahisa Sato, deputet i partisë në pushtet, Partia Demokratike Liberale. Kryetari i byrosë për personel në Ministrinë japoneze të Mbrojtjes, Kazuhito Machida, ka thënë se ndalesa duhet të rishqyrtohet, duke e marrë parasysh uljen e natalitetit.

Ky shtet me 125 milionë banorë, ka regjistruar më pak se 800.000 lindje më 2022, në krahasim me mbi dy milionë më 1970. Kryeministri japonez, Fumio Kishida, ka thënë se Japonia duhet ta trajtojë "tani ose kurrë", çështjen e tkurrjes së numrit të popullsisë.



Avokati i Thaçit fiton betejën në Gjykatën Speciale përballë ZPS-së

HAGË, 7 QERSHOR - Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Hagë ka humbur betejën përballë avokatit Dastid Pallaska, i cili është pjesë e ekipit mbrojtës të ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi. Kreu i trupit gjykues në rastin e liderëve të UÇK-së, Charles L. Smith, ka marrë vendim për ta refuzuar kërkesën e prokurorisë për t'ia tërhequr vëmendjen Pallaskës për deklaratat e bëra në televizionin publik të Kosovës. Paneli i gjyqtarëve në pikën 17 të vendimit ka hedhur poshtë të gjitha pretendimet e prokurorisë kundër avokatit Pallaska, duke konstatuar se deklaratat e avokatit në "RTK" nuk përbënin përpjekje për ta mashtruar

publikun me vetëdije apo për të ndikuar në vendimet e Panelit, nuk ka zbuluar ndonjë informacion konfidencial dhe konstaton se Prokuroria Speciale e Hagës ka dështuar të demonstrojë se "vërejtja" ndaj avokatit është e nevojshme në rrethanat e rastit. Gjithashtu, paneli i gjyqtarëve ka potencuar se kërkesa e Prokurorisë për "vërejtje" do të ishte ndërhyrje në të drejtën e avokatit Pallaska për ta pasur lirinë e fjalës. "Për këto arsye, paneli refuzon kërkesën e PSP-së që z. Pallaska të paralajmërohet", thuhet në pikën 17 të vendimit. Dy javë më parë ekipi mbrojtës i ish-presidentit Hashim Thaçi u ishte kundërpërgjigjur



pretendimeve të Prokurorisë prokurorinë se i ka manipuluar Speciale, duke e akuzuar dhe keqinterpretuar deklaratat e

avokatit Pallaska në "RTK". Gjithashtu, mbrojtja e Thaçit kishte konstatuar se kërkesa e ZPS-së për t'ia tërhequr vërejtjen avokatit Pallaska bazohet në keqinterpretimet që ua ka bërë komenteve publike të avokatit Pallaska. "Kërkesa bazohet në keqinterpretime të komenteve të z. Pallaska" ishte thënë në përgjigjen avokatëve të bërë para dy javësh. Avokatët kishin thënë se Zyra e Prokurorit të Specializuar "përmes përdorimit të elipsave ka manipuluar deklaratat e z. Pallaska për të prodhuar një pretendim se z. Pallaska po e akuzon publikisht Prokurorinë se po propagandon të pavërteta, për ta etiketuar Kosovën si shtet kriminal".

Mbrojtja kërkon që Pjetër Shalës t'i zëvendësohet paraburgimi me arrest shtëpiak

HAGË, 7 QERSHOR - Mbrojtja e Pjetër Shalës përmes një parashtrës lidhur me shqyrtimin e paraburgimit, ka kërkuar nga Paneli i Dhomatave të Specializuara të Kosovës (DhSK) ose i Gjykatës Speciale që Shalës t'i zëvendësohet masa e paraburgimit me arrest shtëpiak. "Mbrojtja me respekt kërkon nga Paneli që t'i japë fund ndalimit të vazhdueshëm të të akuzuarit dhe të urdhërojë lirimin e përkohshëm ose vendosjen e tij në arrest shtëpiak në rezidencën e tij në Belgjikë, duke iu nënshtruar çdo kushti që konsiderohet i përshtatshëm", është thënë në parashtrës. Në këtë parashtrës është thënë se mbrojtja mban qëndrimin e saj se ekzistojnë masa të përshtatshme alternative ndaj paraburgimit dhe që duhet të merren parasysh. "Për shembull, kërkesa që i akuzuari të qëndrojë në arrest shtëpiak në rezidencën e tij në Belgjikë mund të zbusë mjaftueshëm çdo rrezik të mundshëm që vjen nga lirimi i përkohshëm i të akuzuarit", është thënë në parashtrës. Po ashtu, sipas mbrojtjes, i akuzuari përsërit gatishmërinë e tij për t'u angazhuar dhe për të dhënë çdo garanci që konsiderohet e përshtatshme për të qëndruar në shtëpinë e tij, për të mos ndryshuar vendbanimin e



tij, për ta dorëzuar pasaportën dhe dokumentet e tjera të udhëtimit, për të raportuar çdo ditë në policinë belge ose autoritete të tjera të rëndësishme, t'i nënshtrohet monitorimit të ngushtë nga autoritetet, të paraqitet dhe të kthehet në gjykatë sa herë që urdhërohet për ta bërë këtë, dhe/ose t'i nënshtrohen çdo kushti tjetër që konsiderohet i përshtatshëm dhe i urdhëruar nga paneli. Po ashtu, është thënë se mbrojtja i mbështet plotësisht parashtrësat e saj të mëparshme mbi paligjshmërinë e vazhdimit të paraburgimit të të akuzuarit. Sipas mbrojtjes, siç është përsëritur së fundi nga paneli, prezumimi i pafajësisë së të

akuzuarit është pika fillestare për vlerësimin e vazhdimit të paraburgimit dhe barra për të vërtetuar se vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm dhe i takon vetëm prokurorisë. Mbrojtja e Shalës ka theksuar se e drejta për liri duhet të jetë rregull dhe paraburgimi duhet të jetë përjashtim, i cili lejohet vetëm kur tregohet se është rreptësisht e nevojshme dhe proporcionale në atë që asnjë masë alternative nuk mund ta zbusë një rrezik të paraqitur nga lirimi i përkohshëm. Mbrojtja ka ritheksuar se siç ka konstatuar Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, arsyet e përmendura për urdhërimin dhe

zgjatjen e paraburgimit nuk duhet të jenë as të përgjithshme dhe as abstrakte dhe se për ta justifikuar vazhdimin e paraburgimit, kërkohen fakte specifike. Sipas mendimit të mbrojtjes, thirrja e vazhdueshme e Prokurorisë në "stimujt dhe mjetet" e të akuzuarit pa ndonjë justifikim të mëtjshëm, si dhe "klime e përgjithshme e lartpërmendur e frikësimit [...] dhe ndërhyrjes" nuk arrin ta përmbushë testin e rreptë dhe të individualizuar për t'u aplikuar kjo masë. Mbrojtja e Shalës ka theksuar se nuk ka pasur asnjë provë apo material tjetër me kusht që të tregojë se i akuzuari ka ndërhyrë

ose mund të ndërhyjë te ndonjë dëshmitar në procedurë. Gjatë muajit shkurt ka filluar gjykimi në këtë rast, ku më 21 shkurt Prokuroria dhe mbrojtja e viktimave kanë paraqitur deklaratat e tyre hyrëse, kurse më 22 shkurt janë dëgjuar deklaratat hyrëse të mbrojtjes së Pjetër Shalës, si dhe deklarata pa betim e tij. Në mars ka filluar paraqitja e provave të Prokurorisë, ku deri më tani janë dëgjuar gjashtë dëshmitarë. Dëshmitari i parë ka filluar dëshminë e tij më 27 mars dhe e ka përfunduar më 28 mars, dëshmitarja e dytë ka filluar dëshminë më 28 mars dhe e ka përfunduar më 29 mars, dëshmitari i tretë ka filluar dëshminë më 29 mars dhe e ka përfunduar më 30 mars, në të njëjtën ditë me dëshmitarin e katërt. Kurse dëshmitari i pestë e filloi dëshminë më 1 maj, ndërsa e përfundoi më 2 maj, ku edhe filloi dëshmia e dëshmitarit të gjashtë, e cila përfundoi më 3 maj. Më pas, dëshmia e dëshmitarit të shtatë filloi më 30 maj, kurse përfundoi më 6 qershor. Shala u arrestua më 16 mars 2021 nga autoritetet belge dhe u transferua në Hagë më 15 prill 2021 në bazë të një kërkesë për bashkëpunim në zbatimin e fletarrestimit dhe urdhrit për transferim lëshuar nga Dhomat e Specializuara të Kosovës.

Formohet grupi punues për themelimin e muzeut për dokumentimin e krimeve serbe në Kosovë

PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Qeveria e Kosovës ka miratuar të mërkurën propozim-vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e konceptit për themelimin e muzeut për dokumentimin dhe prezantimin e krimeve të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës. Me këtë rast, ministri për

Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashedi, ka thënë se nuk është mirë të bëhen përgjithësimet për fajësimet të popujve. Pastaj fjalën e ka marrë kryeministri Kurti, i cili ka thënë se kjo çështje duhet të adresohet në organet shtetërore, por jo të bëhet fajësimi i popujve sepse kjo bie ndesh me qeverisjen e tij.

"Pajtohem që nuk është mirë të bëjmë përgjithësimet për fajësimet e popujve, por nuk e di se si është i gjithë teksti aty, por pajtohem se kjo duhet të adresohet në organet shtetërore për urdhrat që janë bërë, por jo të bëhet fajësimi i popujve sepse kjo nuk përputhet me qeverisjen tonë", ka thënë Kurti.





NDËRKOMBËTARËT NUK HEQIN DORË NGA KËRKESAT E TYRE PËR SHTENSIONIMIN E SITUATËS NË VERI TË KOSOVËS

ShBA-ja dhe BE-ja insistojnë në kërkesat për qeverinë Kurti

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE) janë duke insistuar për zbatimin e tri kërkesave të tyre për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës. Kërkesës për shtensionim të situatës në veri i është bashkuar edhe shefi i NATO-s. Emisari i ShBA-së për Ballkanin, Gabriel Escobar, ka theksuar se nuk ka ndonjë afat për qeverinë Kurti për zbatimin e këtyre kërkesave, por ka bërë me dije se të premtën do të raportojë në Shtëpinë e Bardhë për rezultatet e takimeve në Prishtinë dhe Beograd. Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka pranuar se ka sfida në raportet dypalëshe me emisarin amerikan dhe atë evropian, por ka thënë se është i bindur që do të arrijnë t'i sqarojnë paqartësitë. Në anën tjetër, presidentja Vjosa Osmani ka thënë se Kosova mund t'i shpallë zgjedhjet e reja në komunat në veri, nëse "20 për qind e votuesve nënshkruajnë një petition me këtë kërkesë"

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE) edhe të mërkurën kanë insistuar në zbatimin e tri kërkesave të tyre për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës. I dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se situata në veri të Kosovës duhet të shtensionohet menjëherë dhe se ai nuk do të presë deri në muajin korrik për zgjedhje të reja. "Kryetarët nuk duhet t'i shfrytëzojnë ndërtesat

(komunale), Policia e Kosovës duhet të tërhiqet nga zona përreth (këtyre) ndërtesave dhe protestuesit duhet të largohen. Shpresojmë të ketë zgjedhje të reja dhe ne duam që serbët të marrin pjesë në to pa parakushte", ka thënë Escobar për gazetarët në Beograd, ku së bashku me të dërguarin e Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, kanë takuar presidentin e serb, Aleksandër Vuçiq.

Escobar, i cili në Prishtinë ka kritikuar ashpër kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, për "mungesë bashkëpunimi" në shtensionimin

e situatës, ka thënë se presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, e ka siguruar atë se do ta shfrytëzonte ndikimin e tij për ta bindur komunitetin serb në veri të Kosovës që të merrte pjesë në zgjedhjet eventuale. "Sfida më e madhe për Serbinë tani është t'i bindë serbët që të kthehen në institucionet (e Kosovës). Kjo është ajo ku unë mendoj se ne jemi në linjë me Serbinë. Ne duhet të sigurohemi se ata që marrin pjesë në zgjedhje dhe serbët që kthehen në institucione janë të mirëpritur", ka thënë emisari amerikan.

I pyetur nga gazetarët nëse ka ndonjë përgjigje nga kryeministri i

Kosovës, Albin Kurti, në lidhje me propozimin e komunitetit ndërkombëtar për shtensionimin e situatës në veri, Escobar ka thënë se diskutimet në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Lajçakut do të vazhdojnë edhe pas largimit të këtij të fundit nga Beogradi. "Nuk e di nëse ka pasur ndonjë përgjigje konkrete nga Qeveria e Kosovës. Shpresoj se Qeveria e Kosovës e kupton se ajo që ne po përpiqemi të arrijmë, është një rezultat i qëndrueshëm dhe reciprokisht i dobishëm për të dyja vendet", ka thënë Escobar, duke shtuar se nuk i ka dhënë ndonjë afat Kurtit.


Ai ka thënë se partneriteti i ShBA-së, BE-së dhe Mbretërisë së Bashkuar me Kosovën "është i hapur". Por, nëse Qeveria e Kosovës, ka shtuar ai, merr hapa të njëanshëm dhe largohet nga partneriteti me komunitetin transatlantik, "kjo vetvetiu është një pasojë".

Më tutje, Escobar ka thënë se Kosova dhe Serbia duhet t'i kthehen dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, sepse "në rast se do t'ia kthenin shpinën atij, do t'ia kthenin shpinën Evropës". Ai ka thënë se

ShBA-ja është e përkushtuar që ta ndihmojë edhe Kosovën dhe Serbinë që ta zgjidhin këtë krizë në një mënyrë që përfitojnë të dyja palët.

Escobar ka ripërsëritur qëndrimin e ShBA-së se formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është "kërkesë ligjore" për Qeverinë e Kosovës. "Në një moment, nëse Kosova dëshiron të ecë përpara me integrimin e saj, ajo duhet ta formojë Asociacionin. Pyetja është se a do të ndodhë kjo me këtë qeveri apo me qeverinë e ardhshme", ka thënë Escobar, duke shtuar se Kosova dhe Serbia duhet të përqendrohen në planin e zbatimit të marrëveshjes së Ohrit për normalizimin e marrëdhënieve. Kjo marrëveshje, mes të tjerash, parasheh zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut, përfshirë edhe atë për Asociacionin. "Unë ende mendoj se mund t'i kemi të gjitha elementet, shumicën e elementeve, të realizuara këtë vit kalendarik", ka thënë Escobar.

Ndërsa i dërguari i Bashkimit Evropian, Miroslav Lajçak, ka çmuar gatishmërinë e presidentit



serb, Aleksandër Vuçiç, për, siç ka thënë ai, për të kontribuar në gjetjen e një zgjidhjeje politike për tensionet në veri të Kosovës. “Në Beograd, Escobari dhe unë kemi pasur diskutime të gjata me presidentin Vuçiç lidhur me situatën komplekse të serbëve në Kosovë. Dhuna nuk është kurrë e pranueshme, dhe kemi nevojë urgjente për zgjidhje politike për krizën aktuale”, ka shkruar Lajçaku në “Twitter”.

Në anën tjetër, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se dhuna është duke e kthyer prapa Kosovën dhe gjithë rajonin, derisa ka kërkuar edhe shtensionimin e situatës në veri të vendit. “Dhuna po e kthen prapa Kosovën dhe gjithë rajonin, duke vënë në pikëpyetje aspiratat euroatlantike. Si Prishtina ashtu edhe Beogradi duhet të ndërmarrin hapa konkretë për ta depërshkallëzuar situatën, të përmbahen nga sjelljet e mëtejshme të papërgjegjshme dhe të angazhohen në dialog me mbështetjen e BE-së, e cila është e vetmja rrugë për paqe të qëndrueshme”, ka thënë ai për gazetën malazeze “Pobjeda”. Ai ka thënë se NATO dënon fuqishëm sulmet e fundit të paprovokuara ndaj trupave të KFOR-it në veri të Kosovës, në të cilat janë plagosur pothuajse 40 paqeruajtës. Stoltenbergu ka përmendur edhe “aktorë të huaj” në rajon që punojnë për minim të paqes.

Kurti: Kemi sfida në raportet me emisarët perëndimorë, por nuk mendoj se gjërat zgjidhen me trysni

Lidhur me situatën në veri dhe kërkesat e ShBA-së dhe BE-së nuk kanë munguar as reagimet nga Kosova. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pranuar se ka sfida në raportet dypalëshe me emisarin amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhe atë evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, por ka thënë se është i bindur që do të arrijnë t'i sqarojnë paqartësitë. “Kam qenë konstruktiv, i përkushtuar, kreativ dhe jam që të gjitha këto, por nuk mendoj se këto gjëra zgjidhen me trysni e me përmendje pasojash, ndoshta edhe sanksionesh të shtetit më demokratik dhe më progresist në

Ballkanin Perëndimor. Unë jam i bindur që do të mund t'i sqarojmë paqartësitë. Kemi sfida me emisarët evropianë dhe amerikanë, por marrëdhëniet tona bilaterale me BE-në dhe ShBA-në janë të shkëlqyeshme”, ka thënë Kurti.

Kështu është përgjigjur kryeministri Kurti kur është pyetur nga gazetarët për deklaratën e Escobarit, i cili ka thënë se nëse Prishtina dëshiron të ecë drejt integritimit evropian, ajo duhet ta formojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

Gjatë takimit më 5 qershor në Prishtinë me Escobarin dhe Lajçakun, Kurti ka thënë se ka ofruar një “dalje të qëndrueshme dhe të sigurt” nga kriza në veri, e cila, sipas tij, është shkaktuar “nga strukturat ilegale dhe paralele të Serbisë atje”. “E para është sundimi i ligjit. Kemi me dhjetëra ushtarë të NATO-s, policë të Kosovës dhe gazetarë të cilët ishin viktimë të një egërsie të paparë të ekstremistëve të dhunshëm e të grupeve kriminale. Në Kuvendin e Kosovës unë i kam përmendur 33 emra, 5 të tjerët janë në burg, të tjerët nuk janë. Dhe të gjithë këta kriminelë, ekstremistë të dhunshëm që sillëshin atë ditë pors një milici fashiste, duhet sa më parë të përballen me drejtësinë. Ka prej tyre që kanë ardhur nga Serbia në Kosovë. Pra, pika e parë është sundimi i ligjit”, ka thënë Kurti gjatë një deklarimi për medie në Mitrovicë.

Ai ka thënë se këto “grupe kriminale” duhet të përballen me drejtësinë për “krimet dhe shkeljet që kanë bërë, prej djegies së veturave e te plagosjet me armë zjarri, shok-bomba e granata dorë”.

“E dyta është që në përputhje me largimin e këtyre grupeve dhe përfundimit të të gjitha trazirave të dhunshme, të kemi zvogëlim të pranishëm të policisë nëpër ndërtesa komunale në tri komunat në veri dhe më pastaj do të mund të angazhoheshim në një proces fer, demokratik zgjedhor për zgjedhjet e parakohshme sepse jemi të vetëdijshëm që dalja ka qenë shumë e ulët herën e kaluar. Pra, po zgjedhje të reja, zgjedhje të parakohshme, por pas sundimit të ligjit dhe pas përgatitjes së terrenit”, ka thënë Kurti. Sipas tij, përgatitja e terrenit për zgjedhje të parakohshme në komunat në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe, nënkupton që ato të jenë të lira dhe të ketë fushatë parazgjedhore, po ashtu, të lirë, fer dhe demokratike. “Unë jam i gatshëm për diskutime, bisedime, por ritheksoj, republikën tonë demokratike, shtetin tonë të pavarur, Kosovën sovranë nuk e dorëzojmë asnjëherë, për asnjë çmim para milicisë fashiste, para këtyre grupeve kriminale e ekstremistëve”, ka thënë Kurti.

Osmani e hapur për zgjedhje të reja në komunat në veri

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është shprehur pro zgjedhjeve të reja në katër komunat veriore të vendit. Në një intervistë për “Reuters”, Osmani ka thënë se Kosova mund t'i shpallë zgjedhjet e reja, nëse 20 për qind e votuesve nënshkruajnë një peticion me këtë kërkesë. Sipas Osmanit, peticioni është “mënyra më demokratike” për shpallje të zgjedhjeve. “Në këtë

mënyrë, mendoj se garantojmë pjesëmarrjen e serbëve, sepse kërkesa do të duhej të vinte prej tyre, prej qytetarëve”, ka thënë ajo për “Reuters”. Por, para shpalljes së zgjedhjeve, Osmani ka thënë se Kosovës i nevojitet garanci nga ndërkombëtarët se Beogradi s'do të ndërhyjë.

Ajo e ka përshkruar presidentin serb Aleksandër Vuçiç si “burrë dramatik”. “Vuçiç, në shumicën e takimeve të tij, është goxha burrë dramatik. Prandaj, ai, natyrisht se ka tentuar të krijojë drama sërish, mirëpo nuk ka ofruar ide që mund të kontribuojnë në paqe dhe stabilitet në rajon”. “Ai dëshiron të pretendojë se po bën koncesione të mëdha, që ai është nën presion të madh, që po vuan, që është në rrezik, e gjëra të ngjashme. Mirëpo diçka e tillë nuk duhet të tolerohet pas moshës katërvjeçare”, ka thënë Osmani.

Situata në veri të vendit është tensionuar nga 26 maji, kur Policia e Kosovës asistoi kryetarët e tri komunave veriore, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, që të futen në zyrat e tyre, përkundër rezistencës së serbëve lokalë. Situata ka eskaluar më 29 maj, kur serbët lokalë u përplasën me ushtarët e KFOR-it të cilët i ruanin objektet komunale. Atë ditë mbetën të lënduar 30 ushtarë të KFOR-it, njëmbëdhjetë të kontingjentit italian dhe 19 të tjerë të kontingjentit hungarez. Lëndimet e tyre përfshijnë fraktura të gjymtyrëve, djegie, ndërkohë që tre ushtarë hungarezë janë të plagosur me armë zjarri. Komandanti i KFOR-it, Angelo Michelle Ristuccia, ka deklaruar se po të mos ndërhynte KFOR-i në veri, “tani do të ishim duke

mbajtur zi për të vdekurit”. “Nëse nuk do të kishim ndërhyrë, tani do të ishim duke mbajtur zi për të vdekurit”, ka deklaruar Ristuccia. Faktori ndërkombëtar ka bërë thirrje të vazhdueshme për uljen e tensioneve dhe, së fundi, disa kanë kërkuar mbajtjen e zgjedhjeve të reja në veri.

Ambasadori britanik takon Krasniqin dhe Adixhikun

Situata në veri ka vënë në lëvizje edhe ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë, Nicholas Abbott, i cili ka takuar të mërkurën liderët e dy partive opozitare.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka bërë me dije se me ambasadorin Abbott kanë biseduar për zhvillimet e fundit në vend. “Në selinë e PDK-së kisha kënaqësinë ta pres sot ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott, me të cilin diskutuam për zhvillimet e fundit në vend. Në këtë takim shpreha qëndrimin e PDK-së në lidhje me situatën aktuale, e cila, fatkeqësisht, është serioze dhe shqetësuese. Ambasadorin Abbott e sigurova se populli i Kosovës vazhdon të mbetet i orientuar drejt dhe bindshëm në rrugën euroatlantike dhe çmon raportet e mira me aleatët tanë ndërkombëtarë. Ambasadorit Abbott ia rikonfirmova qëndrimin konsistent të PDK-së, që interesat e shtetit dhe popullit tonë do t'i vë gjithmonë para interesave partiake”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”.

Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka pritur në takim ambasadorin britanik Nicholas Abbott, me të cilin, po ashtu, ka diskutuar për situatën aktuale politike në vend, me theks të veçantë për gjendjen e tensionuar në veri të vendit. Nga LDK-ja kanë bërë me dije se Abdixhiku e ka njoftuar Abbottin për qëndrimin e partisë që drejton lidhur me ngjarjet në veri si dhe nevojën që në momente të tensioneve e provokimeve nga Serbia, ecja e përbashkët me aleatët për të përballuar një krizë është domosdoshmëri. “Në këtë moment, Kosovës i duhen gjithë miqtë e saj; përplasia me ta është devijim strategjik e dështim diplomatik me pasoja afatgjata”, ka njoftuar LDK-ja.



Qeveria e Kosovës abuzoi me besimin e ShBA-së



WASHINGTON, 7 QERSHOR - Grindja me amerikanët i dëmton interesat e Kosovës ka thënë ish-ndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, Daniel Fried. Sipas tij, ShBA-ja nuk ka qenë kurrë kaq e zemëruar me Qeverinë e Kosovës dhe një gjë e tillë është “mjafat shqetësuese”.

Kryeministri Albin Kurti dhe ekipi i tij “e kanë marrë mbështetjen amerikane si të mirëqenë. Ata kanë abuzuar me besimin amerikan në atë mënyrë që do të jetë e vështirë për ta që ta rregullojnë”, ka thënë Fried në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”.

Reagimi vjen pas kritikave të ashpra që bëri i dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, në adresë të Kurtit, të cilin e ka fajësuar për mungesë bashkëpunimi për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës.

Tensionet në këtë pjesë të vendit, të banuar me shumicë serbe, janë të larta qysh më 26 maj, kur kryetarët shqiptarë të komunave kanë marrë detyrën, përkundër rezistencës së banorëve lokalë.

Zoti Fried, i dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ishte shumë kritik ndaj Qeverisë së Kosovës për situatën e tensionuar në veri të vendit. Ai e kritikoi kryeministrin Albin Kurti për mungesë bashkëpunimi në uljen e tensioneve. Kurti, në anën tjetër,

këmbëngul se nuk mund të bëjë kompromise për “republikën demokratike”. Cili është koment i juaj?

Daniel Fried: Është e qartë që Kosova është duke i injoruar shqetësimet e Shteteve të Bashkuara dhe duke vepruar në një mënyrë që ne nuk e inkurajojmë. Unë kurrë nuk e kam parë administratën e ShBA-së kaq të zemëruar me Qeverinë e Kosovës, jo në këta 15 vjet që nga shpallja e pavarësisë.

Qeveria amerikane i ka inkurajuar kosovarët që të mos e bëjnë këtë problem në veri dhe kosovarët na kanë injoruar. Dhe, rezultatet janë pikërisht ato për të cilat i kemi paralajmëruar. Unë nuk kam dyshim në supozimet e mia. Përndryshe nuk mund ta shpjegoj se përse ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, dhe Gabriel Escobar do të ishin aq të irrituar. Unë supozoj se ata i kanë arsytet e tyre. Unë supozoj se arsytet e tyre bazohen në injorimin që ua bëri Kurti paralajmërimeve të tyre dhe në të konsideruarit e mbështetjes së ShBA-së si të mirëqenë – çfarë ka qenë gabim dhe e habitshme.

Ai (Kurti) e ka bërë presidentin e Serbisë (Aleksandër) Vuçiq të duket empatik. Nuk kam menduar se kjo është e mundur, marrë parasysh se serbët janë burim i problemit, sepse janë ata që refuzojnë ta njohin pavarësinë e Kosovës dhe refuzojnë ta njohin realitetin se Serbia nuk do ta ketë më kurrë (Kosovën). Por,

pavarësisht kësaj, Kurti ka arritur t'i dëmtojë marrëdhëniet me ShBA-në për asnjë interes që unë mund ta identifikoj. Është mjafat shqetësuese. Unë nuk e kam parë kurrë qeverinë amerikane kaq të zemëruar me Qeverinë e Kosovës.

Pra, mendoni se Kurti po shkon shumë larg në rrethanat aktuale...

Daniel Fried: Po, mendoj se ka bërë gabim në gjykime. Ai e definoi sovranitetin e Kosovës në atë mënyrë që e bën të ndihet se mund të kërkojë asgjë tjetër, përveç maksimumit. Dhe, duke vepruar kështu, ai e ka bërë situatën e keqe edhe më të keqe.

Escobari, duke folur për masat kundër Kosovës nëse Kurti nuk është konstruktiv, tha se ShBA-ja “nuk mund të planifikojë asgjë për Kosovën”... Çfarë do të thotë kjo për Kosovën?

Daniel Fried: Mendoj se ai po shpreh zhgënjimin e administratës [amerikane] me Kurtin dhe po e bën të qartë se Kurti dhe ekipi i tij e kanë marrë mbështetjen amerikane si të mirëqenë. Ata kanë abuzuar me besimin amerikan në atë mënyrë që do të jetë e vështirë për ta që ta rregullojnë, por më mirë të nisin e ta bëjnë një gjë të tillë. E përsëris, burimi afatgjatë i problemit në marrëdhëniet Kosovë - Serbi vjen nga Beogradi, nga revanshizmi serb, ndërsa Kurti ka arritur të grindet me ShBA-në. Grindja me amerikanët i dëmton interesat e Kosovës në

atë mënyrë që unë s'e kuptoj. Unë nuk e di se çfarë ka menduar ai (Kurti).

Escobari, po ashtu, e ka bërë të qartë se kjo situatë nuk ka të bëjë me popullin e Kosovës, por me një individ, duke aluduar te Kurti. Ku po e dërgon Kurti Kosovën?

Daniel Fried: Do të ishte më mirë që Kurti të ndërmerre një hap prapa dhe të gjente një mënyrë që do t'i riparonte raportet me ShBA-në. Çdo drejtim tjetër mund të bëhet shumë më i kushtueshëm. Nuk e di se çfarë mbështetjeje ka brenda Kosovës, nëse shihet si ai që i ka thyer marrëdhëniet me ShBA-në, e cila, para së gjithash, ishte e para në mbështetjen e pavarësisë së Kosovës dhe sigurisë në Kosovë.

Shumë në Kosovë pyesin pse vetëm Kosova ndëshkohet, ndërsa Serbia jo.

Daniel Fried: Kjo ka të bëjë, sipas të gjitha gjasave, me besimin e keq në Qeverinë e Kosovës. E thashë, burimi themelor i problemit është në Beograd. Që Shtetet e Bashkuara të jenë aq të zemëruara me Qeverinë e Kosovës, këtu duhet të ketë ndodhur një akt i keqbesimit. Nuk e di me siguri, por është supozimi im.

Si do ta vlerësonit qasjen e administratës amerikane ndaj Kosovës dhe Serbisë?

Daniel Fried: Mendoj se para këtij shpërthimi të fundit, ShBA-ja e konsideronte problemin në

Beograd dhe besonte se kosovarët, gradualisht, mund të dilnin në një gjendje relativisht të mirë. Por, asaj i duhet një partner në Kosovë për ta ndihmuar në stabilizimin e veriut. Mendoj se administrata amerikane ndien se nuk e ka atë partner tani.

A mendoni se situata në veri mund të ketë një ndikim më të gjerë në rajon?

Daniel Fried: Sigurisht. Nuk ka asgjë të mirë që del prej kësaj. Do të ishte keq nëse çon në një konflikt të hapur, mendoj në përshkallëzim të tensioneve ose përshkallëzim të luftimeve dhe vdekje. Mendoj se Kurti duhet të veprojë shpejt për të vendosur së paku një marrëdhënie pune me administratën amerikane. Njerëzit bëjnë gabime. Këshilla ime do të ishte që t'i rregullojë ato, por nuk e di nëse jemi ende në atë pikë.

Sa përfiton aleatja e Serbisë, Rusia, nga kjo situatë?

Daniel Fried: Shumë. Ky është një lajm i mirë, i mirëpritur për Kremlinin dhe (ministrin e Jashtëm rus, Sergei) Lavrovin. Atyre u pëlqen t'i shohin Shtetet e Bashkuara duke u grindur me Kosovën. Do të jenë oportunistë dhe do ta shfrytëzojnë.

Çfarë do t'i sugjeronit Kurtit?

Daniel Fried: Të gjejë një mënyrë për të biseduar me Shtetet e Bashkuara pa zhurmë dhe të gjejë një mënyrë për t'u larguar nga ky konfrontim.

Përfundon transferimi i ushtarëve turq në Kosovë

Prishtinë, 7 qershor - Ka përfunduar transferimi i një batalioni komando pas kërkesës së Komandës së Forcës së Përbashkët të NATO-s. Një pjesë tjetër e batalionit komando të Komandës së Brigadës 65 të Mekanizuar të Këmbësorisë, e

vendosur në rrethin Luleburgaz të qytetit Kırklareli, e cila ishte caktuar si njësi rezervë, ka mbërritur në aeroportin ushtarak në Çorlu. Ushtarët turq, pas përgatitjes në këtë vend, me avionë ushtarakë janë nisur drejt Aeroportit Ndërkombëtar

“Adem Jashari” në Prishtinë. Ushtarët janë pritur nga ambasadori turk në Prishtinë, Sabri Tunç Angli, ndërsa më pas kanë kaluar në kazermën “Sulltan Murat”.

Rritja e numrit të ushtarëve të NATO-s në Kosovë vjen pas tensioneve në veri të vendit.





S'kalon rezoluta e PDK-së për shkarkimin e ministres Hajdari

PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk e kanë votuar propozim-rezolutën për gjendjen në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë

dhe Tregtisë (MINT). Këtë propozim e kishte bërë më herët grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Përmes kësaj rezolute PDK-ja kishte

kërkuar shkarkimin e ministres së MINT, Rozeta Hajdari. Projekt-rezoluta i ka marrë vetëm 26 vota për dhe 60 deputetët ishin kundër saj.

Lirohen nga akuza dy të akuzuarit për vrasjen e trefishtë në Kaçanik

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktgjykim liruës ndaj Afet dhe Agron Dalloshit lidhur me akuzën se me 40 fishekë kishin vrasur tre persona në Kaçanik dhe e kishin lënduar një tjetër.

Aktgjykimi ndaj dy të akuzuarve është shpallur të mërkurën nga kryetari i trupit gjykues, Naser Foniqi. Sipas aktgjykimit, nuk është provuar se ata kanë kryer veprat penale që iu viheshin në barrë. "Gjykata nuk i ka marrë për bazë deklaratat e dëshmitarëve të privilegjuar Besnik Hasani, Shpend Qerimi dhe Nysret Cena, sepse sipas Kodit të Ri të Procedurës Penale, deklaratat e bashkë të akuzuarve nuk mund të merren si prova kur gjykata vendos për çështjen", ka thënë gjykatësi Foniqi në arsyetim të vendimit. Të gjitha shpenzimet procedurale bien në barrë të gjykatës. Për realizimin e kërkesës pasurore-juridike pala e dëmtuar udhëzohet në kontest civil.

Palët e pakënaqura ndaj këtij aktgjykimi kanë të drejtë ankese brenda afatit ligjor prej 30-ditësh. Në lidhje me këtë rast, Prokuroria Speciale kishte ngritur aktakuzë më 2 nëntor 2009 ndaj të akuzuarve Besnik Hasani, Shpend Qerimi dhe Nysret Cena, për veprat penale të vrasjeve, kurse ndaj Hasanit dhe Qerimit edhe për veprën penale të armëmbajtjes pa leje, raporton "Betimi për Drejtësi".

Lidhur me këtë, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me aktgjykimin e 7 shkurtit 2011, të akuzuarit Hasani dhe Qerimi i ka shpallur fajtorë, duke iu shqiptuar dënim me burgim afatgjatë, çdonjërit nga 33 vjet, kurse të akuzuarin Nysret Cena e ka liruar nga aktakuza në mungesë të provave.

Pas shpalljes së këtij aktgjykimi, i akuzuari Hasani ka dashur të japë deklaratë në prokurori lidhur me vrasjet e datës në mes të 27 e 28



shtatorit 2007 andaj Prokuroria, pas dëgjimit të tij, kishte ngritur aktakuzë më 13 shtator 2011 ndaj Nysret Cenës, Agron Dalloshit dhe Afet Dalloshit.

Sipas aktakuzës, të akuzuarit Agron Dalloshi e Afet Dalloshi thuhet, sipas marrëveshjes paraprake të tyre dhe Shpend Qerimit, më 28 shtator 2007, rreth orës 00:10-20, për shkak se Nysret Cena kishte pasur fjalosje me N.B. për shkak të një borxhi dhe i akuzuari Afet Dalloshi kishte pasur fjalosje më parë me N.B., për një vajzë, ashtu që me qëllim që të privojnë nga jeta atë, i akuzuari Afet Dalloshi me veturën e tipit "Audi A4", pronë e Nysret Cenës, ka bartur Nysret Cenën dhe të akuzuarin Agron Dalloshi, që të dy të armatosur me pushkë automatike, deri tek ura mbi lumin Lepenc në fshatin Soponicë, ku kanë zënë vend afër gardhit të gjallë.

Më tutje, në aktin akuzues është thënë se, sipas marrëveshjes, të akuzuarit Besnik Hasani e Shpend Qerimi, me veturën e të akuzuarit Afet, kanë shkuar në restorantin "Mani" i cili ndodhet në magjistralen Ferizaj - Kaçanik për ta parë momentin kur N.B. do të hyjë në veturën e tij për të shkuar në shtëpi, ashtu që me të rëna të borisë së veturës ta informojnë Nysret Cenën dhe të akuzuarin Agron se N.B. ka arritur tek ura mbi lumin Lepenc. Gjithnjë sipas aktakuzës, në veturë të N. B. kanë qenë edhe S. B., U. B. dhe Bujar e Safik Baftiu, dhe i akuzuari Agron me Nysret Cenën, kur e kanë parë veturën, me dashje që t'i privojnë nga jeta, me pushkë automatike kanë shtënë me rafalë të gjata 40 fishekë.

N. B. është goditur me shumë predha në anën e djathtë të trupit dhe me një predhë në anën e

djathtë të kokës dhe ka ardhur deri te vdekja e tij, ndërsa S. B. dhe U. B., për shkak të dëmtimit të zemrës, mushkërive dhe mëlçisë, kanë vdekur, ndërsa Bujar Baftiu nga predha e goditur ka pësuar lëndime të rënda trupore të rrezikshme për jetë, kurse Sadik Baftiu ka shpëtuar i palënduar.

Me këtë, të akuzuarit Agron dhe Afet Dalloshi, në bashkëkryerje me të akuzuarit Besnik Hasani, Shpend Qerimin dhe Nysret Cenën, sipas aktit akuzues, kanë kryer veprat penale: të vrasjes së rëndë nga neni 147, paragrafi 1, nënparagrafi 3.9 dhe 11 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës dhe veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë nga neni 147, paragrafi 1, nënparagrafi 3 e 11 lidhur me nenin 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës.

Në dispozitivin e dytë, të

akuzuarit Nysret Cena dhe Agron Dalloshi thuhet se më 27 dhe 29 shtator 2007, pa autorizim, kanë poseduar dhe bartur çdo njëri nga një pushkë automatike "AK-47", me ç'rast me ndihmën e tyre, tek ura e lumit Lepenc në fshatin Soponicë, privuan nga jeta N. B., S. B. dhe U. B., kurse tentuan t'i privojnë nga jeta edhe Sadik dhe Bujar Baftiun.

Me këtë, sipas aktakuzës, kanë kryer çdonjëri veç e veç veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve" nga neni 328, paragrafi 2 i KPK-së. Por që me aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Speciale më 5 mars 2012, është ndryshuar përkrahimi i dispozitivit të aktakuzës së 13 shtatorit 2011, ashtu që sa iu përket veprave penale nën pikën I të aktakuzës, Nysret Cena nuk e kishte cilësinë e të akuzuarit.

Dy organizata ndërkombëtare u dalin në ndihmë të prekurve nga vërshimet në Mitrovicë

MITROVICË, 7 QERSHOR (ER) - Organizata "Help - Hilfe zur Selbsthilfe Kosovo" dhe Fondacioni "Z Zurich" të mërkurën kanë bërë dhurimin e pajisjeve elektro- shtëpiake për 28 familje të cilat janë prekur nga vërshimet në Mitrovicë. Me rastin e dhurimit të këtyre pajisjeve mori pjesë

drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, Elvis Feka dhe përfaqësuesja nga "Z Zurich Foundation", Afërdita Gjoklaj.

Ky donacion përmbante mjete elektrike shtëpiake si: frigorifer, shporet elektrik, shporet me dru dhe rrobalarëse. Me këtë rast, drejtori Feka ka falënderuar

organizatën gjermane "Help" dhe Fondacionin "Z Zurich" për ndihmën e dhënë këtyre familjeve, si dhe ka shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar në projekte të ndryshme që kanë të bëjnë në mirëqenien e qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik të qytetit.



210 milionë euro për qiranë e burgjeve, qeveria vendos për marrëveshjen me Danimarkën

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze.

Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se

qëllimi i këtij projektligji është forcimi edhe më tutje i raporteve me Danimarkën.

“Qeveria e Kosovës, konkretisht Ministria e Drejtësisë, në bazë të vendimit, ka zhvilluar negociata me Mbretërinë e Danimarkës, andaj pas zhvillimit të këtyre negociatave është nënshkruar edhe traktati ndërmjet dy vendeve. Qëllimi është forcimi

i mëtejshëm i marrëdhënieve ekzistuese të bashkëpunimit të të dyja vendeve duke marrë parasysh zhvillimin pozitiv në shërbimet korrektuese”, ka thënë ministrja Haxhiu.

Projektligji në fjalë është votuar në mënyrë unanime nga kabineti qeveritar. Kosova përfiton 210 milionë euro nga qiraja e burgjeve për të burgosurit danezë.



Haradinaj: I kemi votat e mjaftueshme për iniciimin e mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë Kurti

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka deklaruar se i kanë votat e nevojshme të deputetëve për ta iniciuar mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë Kurti.

Ish-kryeministri Haradinaj para gazetarëve ka thënë se është i papranueshëm eskalimi i fjalorit të kryeministrit Albin Kurti ndaj aleatëve. Sipas tij, një gjë e tillë e bën të vështirë rrugën përpara.

Kreu i AAK-së ka thënë se mocioni i mosbesimit është

zgjdhja e duhur. Ai ka theksuar se Kosova ka pranuar tri kërkesat e ShBA-së dhe të BE-së për deeskalimin e situatës. “Mocioni është zgjidhja e duhur, është demokraci dhe kjo do të ishte me siguri e dobishme për gjithë spektrin politik, përfshirë edhe shumicën, për pozitën. Janë votat, opozita e ka numrin e nevojshëm për ta iniciuar mocionin, po ashtu ka plot deputetë në Kuvendin e Kosovës që nuk pajtohen me këto tejkalimet e panevojshme të kryetarit të qeverisë”, ka thënë Haradinaj.



Osmani dekoron Ismail Kadarenë me urdhrin “Hasan Prishtina”



PRISHTINË, 7 QERSHOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka dekoruar shkrimtarin Ismail Kadare me urdhrin “Hasan Prishtina”. Me këtë rast, Osmani ka thënë se me veprat e tij shkrimtari Kadare ka mbrojtur e promovuar kulturën, traditat dhe gjuhën shqipe. Ajo ka theksuar se Kadare ka qenë një gardian i së drejtës së popullit shqiptar. “Si mirënjohje në emër të popullit të Kosovës, nderojmë shkrimtarin tonë të shquar, zotin Ismail Kadare, vepra e të cilit është enciklopedi artistike e jetës së rëndomtë të shqiptarëve, e historisë së tyre, dokeve e traditave dhe, mbi të gjitha, e gjuhës shqipe. Jam shumë i lumtur që jeni këtu kur Prishtina jonë e dashur është veshur me petkun e librit. Prania juaj në panairin e librit është një

mesazh i rëndësishëm”, ka thënë Osmani.

Ndërsa shkrimtari Ismail Kadare ka thënë se për të nuk ka nderim më të madh se dekorata që ka marrë nga presidentja Osmani. “Jam shumë i prekur që jam në mes jush për këtë nderim kaq të madh. Është një fat i rrallë që një popull të nderojë dhe të të quajë bashkëmbrojtës të të drejtave të tij. Për fat të keq, Shqipëria ka pasur një rrugë të gjatë historike të shkelur me këmbë nga forcat e huaja por, për fat të mirë, ajo i ka kapërcyer vështirësitë e errëta të historisë dhe gjithçka tjetër që mund ta pengojë një popull që të jetojë i lirë. Vetë mbledhja jonë këtu tregon triumfin e popullit shqiptar. Nuk ka nderim më të madh për një intelektual sesa kjo që po e përjetoj sot këtu”, ka thënë Kadare.

Më 14 qershor mbahet mbledhja e përbashkët e dy qeverive

PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Kryeministri i vendit, Albin Kurti, ka bërë me dije të mërkurën, më 14 qershor do të mbahet mbledhja e përbashkët e Qeverisë së

Kosovës me atë të Shqipërisë. Kurti ka treguar se kjo mbledhje do të mbahet në qytetin e Gjakovës. “Sot një javë do të jetë mbledhja nëntë e përbashkët e qeverive Kosovë

- Shqipëri, e treta në më pak se dy vjet. Në mbledhjet e deritanishme kemi nënshkruar 41 marrëveshje”, ka thënë Kurti të mërkurën në mbledhjen e qeverisë.



Qeveria miraton Projektligjin për Fondin Sovran

PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Qeveria e Kosovës ka miratuar në mbledhjen e së mërkurës Projektligjin për Fondin Sovran. Gjatë prezantimit të këtij projektligji, kryeministri Albin Kurti ka thënë se qeveria qëndron fuqishëm pas kësaj nisme, me besimin se do të rezultojë në stabilizim të ekonomisë. "Viti 2017 është viti kur për herë të parë avokojmë për idenë për themelimin e Fondit Sovran. Sot jetësojmë Fondin Sovran me miratimin e Projektligjit për Fondin Sovran

në qeveri. Qeveria jonë qëndron fuqishëm mbrapa këtij vizioni duke besuar se një nismë e tillë do të rezultojë me stabilizim të ekonomisë, përmes diversitetit, krijimit të profitit të shtetit... Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, konstatoj se miratohet", ka thënë Kurti. Themelimi i Fondit Sovran ka qenë një prej premtimeve kryesore të kryeministrit Albin Kurti, bashkë me Bankën Zhvillimore. Gjatë fushatës zgjedhore është përmendur pothuajse në secilin tubim të

tij. Ky premtim është i listuar edhe në faqen zyrtare të Lëvizjes Vetëvendosje si prioritet i qeverisë Kurti. Aty është thënë se Fondi Sovran do t'i marrë nën pronësi asetet strategjike të Republikës së Kosovës dhe do ta ketë përgjegjësinë ekskluzive për investimet në rritjen e vlerës së Trepçës, KEK-ut, Telekomit dhe Postës. "Fondi Sovran do t'i marrë nën pronësi asetet strategjike të Republikës së Kosovës dhe do ta ketë përgjegjësinë ekskluzive për



investimet në rritjen e vlerës së Trepçës, KEK-ut, Telekomit dhe Postës. Agjencia Kosovare e Privatizimit do të shuhet dhe asetet e saj i kalojnë Fondit

Sovran i cili është fond investues dhe instrument i zhvillimit industrial", është thënë në zotimet e Vetëvendosjes.

Rriten çmimet e prodhimit në Kosovë

PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Prodhimit (IÇP) për tremujorin e parë (TM1) 2023. Indeksi i tërësishëm i çmimeve të prodhimit në Kosovë është ngritur për 3.2 për qind ndërmjet TM1 2023 dhe TM4 2022.

Ngritje më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: nxjerrja e xehes së metalit (15.0 për qind); prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës (11.6 për qind); përpunimi i produkteve ushqimore (7.9 për qind); prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t (7.1 për qind); prodhimi i pijeve (6.8 për qind); prodhimi i produkteve kimike (6.0 për qind); prodhimi i mjeteve motorike të (transportit), rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove (4.6 për qind); grumbullimi, trajtimi dhe



furnizimi me ujë (4.6 për qind); prodhimi i produkteve minerale jo metalike (4.2 për qind); prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës (3.3 për qind); xeheroret dhe guroret e tjera (3.2 për qind); prodhimi i pajisjeve elektrike (2.4 për qind); prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara

– thurëse (1.8 për qind); prodhimi i mobilie (0.8 për qind); dhe energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (0.6 për qind).

ASK-ja ka njoftuar se ngritja është neutralizuar nga rënia e çmimeve te: prodhimi i produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (-2.4 për qind); prodhimi i produkteve të

lëkurës dhe produkteve prej lëkurës (-1.4 për qind); dhe prodhimi i metaleve (-0.7 për qind).

Ndërsa krahasuar TM1 2023 me TM1 2022, çmimet e prodhimit kanë pësuar rënie në një mesatare prej (-0.1-përqindësh).

Rënie më të mëdha, sipas degëve të veprimtarive ekonomike, vërehen te: energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (-14.8 për qind); prodhimi i produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (-3.1 për qind); prodhimi i metaleve (-2.5 për qind); prodhimi i produkteve të lëkurës dhe produkteve prej lëkurës (-0.6 për qind); dhe prodhimi i mobilie (-0.3 për qind).

Rënia është neutralizuar nga ngritja e çmimeve te: prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës

(24.5 për qind); xeheroret dhe guroret e tjera (20.9 për qind); prodhimi i pijeve (9.6 për qind); prodhimi i produkteve kimike (9.6 për qind); përpunimi i produkteve ushqimore (9.1 për qind); nxjerrja e xehes së metalit (8.4 për qind); prodhimi i produkteve minerale jo metalike (5.8 për qind); prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t (5.8 për qind); prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës (5.1 për qind); prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara – thurëse (4.6 për qind); grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë (4.6 për qind); prodhimi i mjeteve motorike të (transportit), rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove (2.7 për qind); dhe prodhimi i pajisjeve elektrike (1.2 për qind).

Ekspertët kërkojnë nga qeveria të vendosë taksë për emetuesit e karbonit

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Instituti Riinvest ka mbajtur debat me temën "Dekarbonizimi dhe taksat e karbonit". Nga të pranishmit është thënë se dekarbonizimi është politikë që Kosova nuk mund ta shmangë nëse synon të jetë anëtare e Bashkimit Evropian (BE). Në këtë kontekst ata kanë kërkuar që si në çdo vend të botës edhe në Kosovë të fillojë taksimi i karbonit në mënyrë të mbrohet mjedisi. Përmes një takse karboni është kërkuar nga qeveria të caktojë një çmim që duhet të paguajë ndotësit për çdo ton të emetimeve të gazit. Fjona Bakia nga Instituti INDEP



ka thënë se çmimi në karbon është një politikë që Kosova nuk mund ta shmangë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian (BE). "Taksa e

karbonit është e paevitueshme për Kosovën sado që ne nuk jemi pjesë e BE-së, e organizatave ndërkombëtare. Gjithsesi ne jemi nënshkruar të

Samitit të Sofjes dhe pjesë e komunitetit të energjisë dhe në këto pjesëmarrje ne jemi zotuar për dekarbonizim deri në vitin 2050. E ky zotim nuk duhet me qenë vetëm fjalë, por duhet përcjell me veprime", ka thënë Bakia.

Ndërsa udhëheqësi i Divizionit të Politikave të Energjisë në Ministrinë e Ekonomisë, Adnan Preniqi, ka thënë se synojnë që deri në vitin 2030 konsumi final nga burimet e ripërtërishme të shkojë deri në 30 për qind.

Në anën tjetër, Visar Vokri nga Instituti Riinvest ka thënë se dekarbonizimi në vendet

skandinave ka filluar qysh në vitet '90. Sipas tij, aktualisht janë 40 vende në botë që e praktikojnë dekarbonizimin, me ç'rast ka kërkuar që Kosova të bëhet sa më shpejt pjesë e saj. "Taksa nuk mjafton si e vetme duke pasur parasysh caqet ambicioze që vendet e zhvilluara e kanë para vetes. Madje disa vende e kanë luftë, por kjo është edhe luftë globale. Taksa si e vetme nuk ka prodhuar efektet e duhura deri më sot, andaj vendet e ndryshme të botës kanë filluar të mendojnë më seriozisht për ta adresuar këtë problem", ka thënë Vokri.

Së shpejti do të zhblllokohen të hyrave vetjake të komunave

PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Qeveria e Kosovës ka miratuar të mërkurën plotësim-ndryshimin e Ligjit për Buxhetin, ku do të

zhblllokohen të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara gjatë viteve të kaluara. Në konferencën për medie, pas mbledhjes së qeverisë, ministri

i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se pas miratimit në dy leximet në Kuvend, do t'i hapet rruga edhe ngërçit në Kuvend.

Kujtojmë se ditë më parë kryetarët e komunave i kanë paraqitur shtatë kërkesa qeverisë në lidhje me të hyrat vetjake.



Disa popuj edukohen me kultin e gënjeshtërisë dhe disiplinën e harresës



Thënie nga: **BOUALEM SANSAL** (pjesë nga vepra E fshehta e muxhahedinit gjerman)
Përktheu: **Nonda Varfi**

– Masakrat nuk i bën dot me njerëz të ndriçuar, duhet urrejtje, verbëri dhe demagogji. Gjithnjë, kur lindin shtetet ndërtohen nga të çmendur dhe vrasës. Ata vrasin njerëzit e mirë, përzënë heronjtë, burgosin popullin dhe shpallen liberatorë.

– Ujku, kjo kafshë fantastike, kur këmba i bie në çark, e pret atë me dhëmbë dhe fiton lirinë, të tërën, të paprekur, turbulluese si zanë dashurie ose përpëlitet deri në pikën e fundit të gjakut dhe ngordh i silitur dhe mrekullisht i lehtësuar nga dhimbjet.

– Të dish nuk mjafton. Të kup-tosh nuk mjafton. Dëshira nuk mjafton. Na mungon diçka që nuk e kemi asnjë gram: vendosmëria. Ne jemi si të internuarit e dikurshëm, të zënë në ingranazhin e komplotit, të mbërthyer nga frika, të magjepsur nga e keqja, presim me të fshehtë e shpresës se do të na shpëtojë bindja.

– Ka disa popuj që edukohen me kultin e gënjeshtërisë dhe disiplinën e harresës.

– Besohet se gënjeshtër është mbrojtja sociale më e mirë për popujt, një dhuratë e efektshme për fëmijët rebelë, një mënyrë jetese ngushëlluese për njerëzit e merakosur.

– Vendi është i mbyllur në sën-

duk dhe shtysa është e njëjtë; sa më shumë fukarenj dhe racistë dhe plot mllef të jenë njerëzit, aq më lehtë i tërheq prej hunde.

– Për mendimin tim asgjë nuk ndryshon për rrugaçët. Është njëlloj, vetëm se rrugaçët e vegjël rriten, të mëdhenjtë trashen dhe ata të vegjlit hiqen si kumbarë të kthyer nga lufta. Ndërsa të tjerët, familjet dhe njerëzit normalë, bëjnë jetën e tyre; pak punë, pak papunësi, pak spital.

– Kurthi me i rrezikshëm është kurthi që ti i ngre vetes.

– Ka disa popuj që janë si delet; komandohen o me gisht o me sy.

– Thonë se gjithçka dihet brenda një qyteze. Por, njëkohësisht nuk dimë asgjë, vetëm sa kalojmë

pranë njëri-tjetrit, kujtojmë se dimë, jemi në botën tonë, jo në kokën e të tjerëve, ndjekim mendimet tona, pasi mendimet e të tjerëve nuk mbërrijnë te ne, ose mbërrijnë të deformuara nga fjalët e botës. Ne jemi hije, jemi thashetheme për njeri-tjetrin. Mes nesh ka një mur sikundër ka paragjykime thelbësore.

– Kjo botë më duket aq e largët, aq e gënjeshtërt në hallet e saj, e mbledhur kruspull në vetvete, në kundërshtitë e saj, në kënaqësitë e vogla, në çmenduritë e saj, me të cilat ushqehet si një kanibal që ha veten, pa dyshim me mendje të errësuar nga koha, nga drama e saj, ëndrrat e saj, pafuqia e saj.

– Jam kudo dhe askund. Gjithçka është e ngjashme. Cunami i

mondializimit i ka vënë gomë trashëgimive tona, ka fshirë tiparet intime, nuk njeh as njerëzit e tu as botën.

Situata në veri, mesazhet e Macronit dhe Scholzit, bashkëpunimi Kosovë-Francë, gjithçka...


Fiorentina – West Ham, formacionet e mundshme në finalen e Ligës së Konferencës

Mot me diell, temperaturat deri 26 gradë

Të jesh dashnore nuk është magjepsëse: Edhe ajo është motra, vajza ose bashkëshortja e ...

Femra, është e dobishme të dini: Çfarë do të ndodhë kur menstruacionet kanë ngjyrë të z...

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Prishtina përforcohet me Arti Hajdarin

PRISHTINË, 7 QERSHOR - KB Sigal Prishtina një ditë pasi është përforcuar me basketbollistin Devoe Joseph, i cili ka një përvojë të madhe në Evropë, e ka zyrtarizuar edhe basketbollistin vendor

Arti Hajdari. Ky i fundit ishte ndër më meritoret që Peja është shpallur kampione e Superligës. "Artistikisht shtëpia e kampionëve rritet edhe me një kampion. Arti Hajdari, i cili ka qenë pjesë e

skuadrave si Rahoveci, Feronikeli, Ponte Prizreni dhe Peja, nënshkruan kontratë dyvjeçare me klubin më të trofeshëm në vend. Hajdari specialitet i ka gjuajtjet nga distanca ku

gjatë sezonit të kaluar pati saktësi të mrekullueshme në gjuajtjet për 3 pikë (45 %). Mirë se vjen në shtëpinë e kampionëve, Arti!", thuhet në njoftimin e Sigal Prishtinës.



FFK-ja refuzon ankesën e Ferizajt, Liria në Superligë

"Epoka e re"

Prishtinë, 7 qershor - Komisioni i Garave i Federatës së Futbollit të Kosovës e ka refuzuar ankesën e KF Ferizaj, duke e regjistruar ndeshjen e barazhit me rezultatin e arritur në fushë 0-0 në kohën e rregullt dhe 0-3 në penallti. Në këtë mënyrë skuadra e Lirisë do të jetë pjesë e Superligës në sezonin 2023/2024. Në fakt, Ferizaj e ka humbur finalen ndaj Lirisë së Prizrenit pas penalltive, por më pas kishte bërë ankesë se

futbollisti Liridon Fetahaj ishte paraqitur në ndeshje pa të drejtë, pasi nuk kishte kontratë. Ky pretendim i Ferizajt është hedhur poshtë nga Komisioni i Garave i FFK-së. "Komisioni i Garave konstatoi se KF Ferizaj ka ushtruar ankesë duke kontestuar rregullsinë e kësaj ndeshje për shkak se lojtari Liridon Fetahaj është paraqitur në ndeshje pa të drejtë për shkak të skadimit të kontratës. Gjatë administrimit të ankesës si dhe të gjitha shkresave në lëndë u konstatua se: Për Komisionin e Garave, sipas



nenit 71, paragrafi 1, të Rregullores së Garave, janë përmbushur të gjitha kushtet për administrim dhe vendimmarrje lidhur me ankesën. Se Komisioni i Garave në ecurinë e procedimit juridik të administrimit të provave dhe

të vendimmarrjes ka kërkuar deklarata nga zyrtarët kompetentë të FFK-së. Bazuar në kushtet e përgjithshme për gara dhe sipas nenit 13 të Rregullores së Garave, viti garues fillon më 1 korrik, ndërsa përfundon më 30 qershor të vitit të ardhshëm. Viti është i ndarë në dy stinor: vjeshtor dhe pranveror dhe se ndeshja e barazhit është vazhdim dhe juridikisht kualifikohet si ndeshje e stinorit pranveror që është brenda edicionit të garave për vitin 2022-2023. Po ashtu, edhe sipas nenit 29 të

Propozicioneve të Garave, lojtari Liridon Fetahaj ka qenë i licencuar për edicionin e garave për vitin 2022-2023, kështu që pretendimet e palës ankimore nuk u vërtetuan, prandaj ankesa e KF Ferizajt refuzohet e pabazuar dhe ndeshja e barazhit në mes të KF Ferizaj dhe KF Liria regjistrohet me rezultat të arritur në fushë, në kohë të rregullt dhe pas vazhdimëve 0:0, me penallti 0:3 në favor të KF Liria. Nga theksimet e lartshënuara u vendos si në diapozitiv", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Prishtina ndihet e tradhtuar nga 'Plisat'

PRISHTINË, 7 QERSHOR - FC Prishtina e fitoi Kupën e Kosovës pasi që në finale e mposhti Gjiljanin me rezultat 2-0. Ndeshja ishte e zjarrtë, ndërsa nuk munguan edhe problemet nga tifozët, veçanërisht nga tifo-grupi "Plisat" e Prishtinës. Gjatë tërë ndeshjes "Plisat" nuk treguan përkrahje ndaj lojtarëve që përfaqësojnë ekipin e Prishtinës, por brohoritnin vazhdimisht kundër bordit të klubit kryeqytetas. Tani Prishtina përmes një njoftimi zyrtar ka sqaruar ngjarjet që e përcollën finalen kundër Gjiljanit, duke theksuar se ndihet e tradhtuar nga tifo-grupi i klubit.



qëndruan për t'i përshëndetur futbollistët apo për t'iu gëzuar triumfit. Kjo do të duhej të ishte primare për një grup tifozësh, nëse vetëm kanë harruar qëllimin për çka shërbejnë. U kemi dalë në ndihmë duke u blerë bileta dhe duke i financuar fishekzjarrët dhe koreografinë, por klubi u ndje i

tradhtuar", thuhet në reagimin e Prishtinës. Më tej, Prishtina zbuloi se kjo koreografi nga "Plisat" ishte e paralajmëruar, dhe se kjo gjë ishte bërë me dije nga një aksionar aktual i klubit në televizion, për të cilin gjiganti kosovar nuk kishte fjalë të mira. "Paraprakisht kishim

paralajmërimet dhe njohuri që e njëjta do të ndodhte dhe, për ironi, kjo u paralajmërua nga një aksionar aktual i klubit në televizion. Natyrisht, ky aksionar ka harruar që është pjesë e klubit, edhe pse aktualisht paguhet nga FFK-ja dhe i njëjti për 18 vjet sa është aksionar jo vetëm që nuk ka kontribuar asnjë cent në arkën e klubit, por nuk e mban mend askush të ketë blerë një biletë të vetme për të parë ndonjë ndeshje futbollit në 'Fadil Vokrri'. Ne si klub me shkas nuk vendosëm të reagonim para ndeshjes, duke mos dashur të besojmë se një gjë e tillë do të ndodhte. Megjithatë ndodhi në formën më brutale të mundshme", shkruante në komunikatën e Prishtinës. Po ashtu, klubi kryeqytetas ka bërë me dije se ka dërguar ankesë në KAS të KOK-ut sa i

përket licencimit të klubit për gara evropiane. "Ne duam t'ju njoftojmë që klubi ka dërguar ankesën për licencim në KAS të KOK-ut. Siç e dini, FC Prishtina është klubi i parë i licencuar në Ministrinë e Sportit, por të njëjtat kriteret, sipas FFK-së, ne nuk i plotësuam për të garuar në Evropë. Për ne nuk vlejnjë rregullat e njëjta ashtu siç vlejnjë për klubet e tjera. Këto metoda i kemi parë edhe më herët, ia kemi dalë atëherë, do t'ia dalim edhe tani. Por, të bashkuar do t'ia dalim edhe më lehtë. Andaj, skuadrës sonë i duhet përkrahja juaj më shumë se kurrë më parë. Kemi fituar Kupën e Republikës, e cila na mundëson të luftojmë për të drejtën tonë për ta përfaqësuar vendin në garat e UEFA-së. Dhe nga kjo nuk do të heqim dorë lehtë", shkruante në komunikatën e Prishtinës.

Kurti: Në punën time po e ndjek shembullin e Majlinda Kelmendit

MITROVICË, 7 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se për të pasur sukses në punën e tij si i pari i qeverisë po e ndjek shembullin e kampiones olimpikë në xhudo, Majlinda Kelmendi. I pari i ekzekutivit tha se nga aktiviteti i xhudos që po mbahet në palestrën "Minatori" në Mitrovicë, para

qindra nxënësve nga shkollat e kësaj komune, Majlinda së bashku me shumë xhudistë të tjerë po e demonstrojnë sportin e xhudos në kuadër të projektit "Kosova shtet i xhudos". "Kampionia jonë dhe e arta olimpikë, Majlinda Kelmendi, ka dëshmuar për shumë vjet se cila është rruga që duhet ndjekur për të

arritur deri te suksesi. Dua t'jua them që edhe unë në punën time ndjek shembullin e Majlindës për të arritur sukses", ka thënë Kurti. Ndërsa trajneri i xhudos, Driton Kuka, deklaroi se ky aktivitet po zhvillohet për ta përçarur mesazhin e paqes përmes sportit.




Xavi: Çështja e rikthimit është në dorën e Messit

BARCELONË, 7 QERSHOR - Leo Messi-Barcelona nuk pritet të jetë një telenovelë e gjatë, pasi "pleshti" e ka me nxitim. Në tavolinë e presin disa oferta shumë të fuqishme ekonomike. Sigurisht dëshira e Messit, e trajnerit Xavi, dhe pa

diskutim e tifozëve, është që legjenda argentinase të rikthehet në "Camp Nou". "Situata është e tillë, vendimi është në dorë të presidentit dhe babait të Leos. Të shohim se çfarë do të ndodhë. Në fund vendimi i takon Leos", u

shpreh Xavi duke shtuar: "Për momentin jemi në rregull me planin e financave, tani do të punojmë për ta përforcuar ekipin aty ku ka nevojë". "Përplekja e fundit për Messi"-n shkruan "Sport" në faqen e parë duke

shtuar se presidenti Laporta do të paraqesë ofertën e tij për Messin, gjithashtu do t'i paraqesë La Ligas planin e financave. Në çdo rast Barcelona është e detyruar ta shesë fillimisht për ta bërë të mundur rikthimin e argentinasi.



FC Liqeni e barazon serinë finale, kampioni vendoset në kryeqytet

DRENAS, 7 QERSHOR - FC Liqeni e ka barazuar serinë finale të "play-off"-it të Superligës së Kosovës në futboll. Skuadra nga Drenasi në palestrën "Hysni Jetullahu" fitoi me rezultatin 4:3 ndaj Prishtinës 01, në praninë e një numri të madh të shikuesve. Ndeshja ishte e baraspeshuar deri në fund, por fitues dolën lojtarët e skuadrës nga Drenasi. Liqeni kaloi në epërsi në fillim të ndeshjes, ndërsa kryeqytetasit më pas shënuan dy gola të tjerë për ta përmbysur rezultatin në 2:1. Megjithatë, kolumbiani Camillo i realizoi golat vendimtarë për vendësit. Fillimisht e barazoi rezultatin në 2:2 dhe në fund të pjesës së parë realizoi golin tjetër për 3:2. Dardan Topilla më pas shënoi golin për shifrat 4:2, që edhe e vendosi fituesin. Deri në fund të



ndeshjes Prishtina 01 nuk arriti më shumë sesa ta ngushtojë epërsinë në 4:3 nëpërmjet një autogoli, por nuk e pati forcën ta dërgonte ndeshjen në vazhdimë. Ndeshja e

tretë finale, e cila do ta përcaktojë skuadrën kampione, do të luhet në Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve në Prishtinë më 11 qershor në orën 20:00.

Guardiola: Në Stamboll për ta bërë ëndrrën realitet

MANCHESTER, 7 QERSHOR - Manchester City rikthehet në finalen e Ligës së Kampionëve pas dy vjetëve mungesë. Kampioni në fuqi i Anglisë do të përballë me gjigantën italian Inter që, gjithashtu, kërkon triumfin e madh në Stamboll. E për këtë duel shumë të rëndësishëm për të dyja skuadrat ka folur trajneri i City, Pep Guardiola, duke thënë se shkon në Stamboll për ta bërë ëndrrën realitet. "Jemi kthyer atje ku ishim dy vjet më parë. E rëndësishme është të jesh atje pas disa vjetësh. Kjo është ajo që e bën një klub të madh. Këtu mësova se emocionit i tepërt nuk është për ne. Do të shkojmë në Stamboll për të bërë realitet një ëndërr dhe do të përpiqemi të bëjmë një lojë të mirë", ka thënë Guardiola, i cili ende nuk e ka harruar finalen e humbur nga Chelsea, teksa thotë se ka arritur mjaft sukses deri më tani në Ligën e Kampionëve. "Ne patëm mundësinë dy vjet më parë, nuk ia dolëm. Këtë vit do të përpiqemi të bëjmë më të mirën. Si trajner kam arritur në dhjetë gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve dhe kam arritur në tri finale, duke fituar dy me



Barcelona. Jam në finalen time të katërt si trajner. Liga e Kampionëve më ka dhënë më shumë sesa mund ta imagjinoja. Futbollit jep dhe merr. Jeta është plot me padrejtësi, por gjithçka që është e padrejtë për mua është e drejtë për Atleticoen e Madridit, për Realin dhe, gjithashtu, për Barcelonën", ka shtuar Pep. "Kështu shkon Bota. Ne duam gjithmonë e më shumë... dhe kjo është e gabuar. Duhet të jesh ambicioz... por jo lakmitar. Shumë klube kanë shkatërruar projekte dhe ide sepse nuk arritën ta fitonin Ligën

e Kampionëve. Të tjerët u bënë klube të mëdha sepse ia dolën. Edhe nëse nuk mendoj kështu, e kuptoj se gjithçka që kemi bërë gjatë këtyre viteve do të ketë kuptim për të tjerët vetëm nëse fitojmë". "Nëse nuk fitojmë, gjërat do të dukem se do të kenë më pak kuptim: do të jetë pak e padrejtë, por duhet ta pranojmë. Ne, gjithashtu, duhet të pranojmë se nëse duam të bëjmë një hap përfundimtar dhe të jemi një klub i madh, duhet të fitojmë në Evropë. Duhet ta fitojmë Ligën e Kampionëve", ka deklaruar Guardiola.

SHKURT

Licencohet Federata Aeronautike e Kosovës

Federata Aeronautike e Kosovës ka njoftuar se e ka fituar licencimin në bazë të standardeve të reja të organizatave sportive. "Federata Aeronautike e Kosovës është licencuar në përputhje me standardet e reja të qeverisjes së organizatave sportive. Në bazë të përmbushjes së standardeve mund t'i zhvillojmë veprimtaritë sportive deri në afatin e rilicencimit, ciklin olimpiq 31.12.2024. Njëherësh kemi nënshkruar memorandumun e bashkëpunimit me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) për vitin 2023, në bazë të kategorizimit të sportit dhe rregulloreve në fuqi", thuhet në njoftimin e FAK-së.

Maldini u shkarkua pasi synonte zëvendësimin e Piolit me Pirlon

Paolo Maldini po planifikonte një revolucion te Milani para shkarkimit të tij, duke dashur që klubi ta zëvendësonte trajnerin Stefano Pioli me Andrea Pirlo, raporton "Corriere dello Sport". Drejtori teknik 54-vjeçar u shkarkua nga pronari Gerry Cardinale të hënën pas një takimi të shkurtër, por të tensionuar. Së bashku me Maldinin nga klubi është larguar edhe bashkëpunëtori i tij Frederic Massara. Maldini dhe Massara luajtën një rol vendimtar në rikthimin e Milanit në majat e futbollit italian, duke sjell figura të rëndësishme si Mike Maignan, Rafael Leao dhe Theo Hernandez. Largimet e dyshe e kanë futur klubin në një gjendje kaosi dhe kanë shkaktuar tensione mes lojtarëve.

Unitedi vendos tetë lojtarë në shitje

Manchester United do ta "pastrojë" skuadrën gjatë afatit kalimtar të verës. Sipas "Mirror", "Djajtë e Kuq" planifikojnë t'i shesin tetë futbollistë. Harry Maguire, Anthony Martial, Fred, Scott McTominay, Dean Henderson, Alex Telles, Eric Bailly dhe Brandon Williams janë futbollistët që janë vendosur në shitje nga klubi anglez. Trajneri Ten Hag synon që me shitjen e tyre të blejë futbollistë që do të konkurronin fuqishëm në Ligën e Kampionëve dhe në Premierligë.

Tottenhami ndryshon mendje, Kane nuk largohet

Tottenham Hotspur ka ndryshuar mendje në lidhje me të ardhmen e sulmuesit Harry Kane. "90 min" raporton se "Spurs"-i ia ka komunikuar Harry Kanes vendimin që nuk do ta lejojë largimin e tij gjatë verës. Kontrata aktuale e Kanes me Tottenhamin skadon në fundin e sezonit 2023/24, dhe të dyja palët nuk janë afër ta arrijnë pajtimin për një marrëveshje të re. Për Kanen interesim kanë shprehur Bayern Muncheni, Manchester Unitedi dhe Paris Saint-Germaini. Ndërkohë, Real Madridi është gati të bëjë një ofertë drejt Tottenhamit për Kanen, pas largimit befasues të Karim Benzemas drejt Al Ittihadit.

Verstappeni shuan ëndrrat e rivalëve: Jemi gjithnjë një hap para tyre


Pas triumfit të radhës në kampionatin e Formulës 1, piloti holandez Max Verstappen shkon në +53 pikë nga ndjekësi më i afërt në renditje, shoku i tij i skuadrës te Red Bulli, Sergio Perez. Në garën e fundit në Spanjë, edhe Mercedesi u paraqit mirë,


duke konfirmuar se risitë e paraqitura kishin bërë efektin e duhur në pistë. Gjithsesi, Max Verstappen, kampioni i botës, mendon se askush nuk do t'i afrohet Red Bullit në këtë sezon. "Mendoj se makina deri më tani ka shkuar mjaft mirë. Edhe në garën e fundit ishim të

parët, duke menaxhaur mirë gomat dhe thelluar diferencën me rivalët. Kjo ishte ajo që doja të shitja dhe mora përgjigjen e duhur", ka thënë Verstappen. "Nuk mendoj shumë për kampionatin, se si do të rrjedhin gjërat deri në fund. Unë përqendrohem te gara


ime dhe shkoj çdo fundjavë në garë me idenë e qartë për ta fituar garën. Skuadrat e tjera mund të bëjnë atë që duan, të sjellin risitë që duan", ka thënë holandezi, dy herë kampion bote në Formula 1. Verstappen ka një apel për rivalët, duke u thënë të mos

mendojnë shumë për titullin këtë sezon: "Te Red Bulli kanë bërë një punë të shkëlqyer me këtë makinë dhe të tjera risi janë duke ardhur, çfarë do të bëjnë edhe më të shpejtë. Sado që rivalët tanë të përpiqen, ne do të jemi gjithnjë një hap përpara dhe s'do të na arrijnë".





Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office



NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURISIT

Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 16.05.2023, për vendin e punës:

I. Pozita: Zyrtar i Lartë Ligjor

Numri i referencës: ZLL/ZKA/02-04/23

Konkursi anulohet bazuar në Vendimin nr. 897 të datës 06.06.2023.

Prishtinë, 07.06.2023 Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

D. Shullikova

OBAVEŠTENJE O OTKAZIVANJU KONKURSA

Nacionalna kancelarija revizije obaveštava da se otkazuje konkurs objavljen u dva lokalna medija, na zvaničnom sajtu i oglasnoj tabli NKR-a dana 16.05.2023. godine, za radno mesto:

I. Položaj: Visoki pravni službenik

Broj reference: ZLL/ZKA/02-04/23

Konkurs se otkazuje na osnovu odluke br. 897 od datuma 06.06.2023.

Priština, 07.06.2023 Departman za upravljanje ljudskim resursima

D. Shullikova

Thirrje për aplikim

Artan Babatinca B.I. me NUI: 810782492, po kërkon ofertues /kontraktor/ kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë/propozim për:

“Ndërtimin e serrës së re moderne 3000 m², dhe energji e ripertritshme me kapacitet 4KW”.

Nr. Prokurimit: 07/4-693

Emri: Artan Babatinca B.I.

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit: artanbabatinca1985@outlook.com

Adresa: Rr. “Dëshmorët Babatinca” p.n. Podujevë

Tel: +383 (0) 49 805 870

Ofertat duhen dorëzuar më së largu 15 ditë nga publikimi i shpalljes, deri në ora 15:00, përmes e-mailit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:



- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arjeta Gjoshi shpall të pavlefshme dëftesat e Gjimnazit: Gjergj Kastrioti “Skënderbeu” drejtimi Shkenca Natyrore kl. 10,11,12.
- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Irfan Gerbani shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q K "11 Marsi" Prizren.
- Edin Bicaku shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.
- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” instalues i ujit dhe kanalizimit Gjakovë.
- Visar Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfmu "Bajram Curri" Krushë e Madhe.
- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike “Nexhmedin Nixha” Makinerisë Gjakovë.
- Enver Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIIIshfmu "Fadil Hisari" Prizren.
- Valon Vala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- CelebicEsef shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.
- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të SH.M.E. “Kadri Kusari” Gjakovë.
- XhelalFerizi shpall te pavlefshme certifikatën QK "11 Marsi" Prizren.
- Valmir Kadrija shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Hivzi Sylejmani” Fushë

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Swiss Solar Park" L.L.C Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore në lokalitetin "Madanaj-Ripaj, ZK Kodra e Hutit Gjakova Solar 3" komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 26.07.2023 në ora 11:00 në Objektin/sallën e Kuvendit Komunal në Gjakovë do të organizohet debat publik nga kompania "Swiss Solar Park" L.L.C Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/86180861155?pwd=NUI5OEJvQzVJaUNGY0dVeUJnNXpBQT09>

Meeting ID: 861 8086 1155

Passcode: 5LJExb

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Swiss Solar Park" L.L.C Gjakovë për parkun e energjisë diellore në lokalitetin "Madanaj-Ripaj, ZK Kodra e Hutit Gjakova Solar 2" komuna e Gjakovës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Swiss Solar Park" L.L.C Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore në lokalitetin "Madanaj-Ripaj, ZK Kodra e Hutit Gjakova Solar 2" komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 26.07.2023 në ora 10:30 në Objektin/sallën e Kuvendit Komunal në Gjakovë do të organizohet debat publik nga kompania "Swiss Solar Park" L.L.C Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/86180861155?pwd=NUI5OEJvQzVJaUNGY0dVeUJnNXpBQT09>

Meeting ID: 861 8086 1155

Passcode: 5LJExb

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Swiss Solar Park" L.L.C Gjakovë për parkun e energjisë diellore në lokalitetin "Madanaj-Ripaj, ZK Kodra e Hutit Gjakova Solar 2" komuna e Gjakovës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Swiss Solar Park" L.L.C Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore në lokalitetin "Madanaj-Ripaj, ZK Kodra e Hutit Gjakova Solar 1" komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 26.07.2023 në ora 11:30 në Objektin/sallën e Kuvendit Komunal në Gjakovë do të organizohet debat publik nga kompania "Swiss Solar Park" L.L.C Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/86180861155?pwd=NUI5OEJvQzVJaUNGY0dVeUJnNXpBQT09>

Meeting ID: 861 8086 1155

Passcode: 5LJExb

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Swiss Solar Park" L.L.C Gjakovë për parkun e energjisë diellore në lokalitetin "Madanaj-Ripaj, ZK Kodra e Hutit Gjakova Solar 1" komuna e Gjakovës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Swiss Kosova Power" L.L.C Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore në lokalitetin "Ripaj zk. Kodra e Hutit", Gjakovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 26.07.2023 në ora 10:00 në Objektin/sallën e Kuvendit Komunal në Gjakovë do të organizohet debat publik nga kompania "Swiss Kosova Power" L.L.C Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/86180861155?pwd=NUI5OEJvQzVJaUNGY0dVeUJnNXpBQT09>

Meeting ID: 861 8086 1155

Passcode: 5LJExb

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Swiss Kosova Power" L.L.C Prishtinë për parkun e energjisë diellore në lokalitetin "Ripaj zk. Kodra e Hutit", Gjakovë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues